



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5147 /2021

Data: 21.07.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e gjashtë -VI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.07.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024.
4. Draft plani lokal i veprimtari në mjedis 2021-2026.
5. Informatë për sektorin e emergjencave.
6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- gjatë këtij muaji nuk kemi pasur asnjë rast pozitiv. Janë duke u bërë testet aerologjike dhe testet rapide por numri është i vogël. Deri tash janë bërë 1938 serologjike, ndërsa teste rapide janë bërë 211. Deri më tani janë vaksinuar 1223 qytetarë dhe procesi ka shkuar mirë.

Teuta Shkreta thekson:- ka qenë një sfidë e re që na ka përcjell dhe sa i përket punës çdo gjë ka shkuar në rregull.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- ky dokument është përgatitur nga ekzekutivi i komunës si: kryetari, nenkryetari dhe drejtorët e drejtorive, dhe përbëhet nga 3 pjesë, ku:

- pjesa e parë ka të bëjë me burimet e financimit komunal, (granti i përgjithshëm, i arsimit, i shëndetësisë dhe nga te hyrat vetanake),
- pjesa e dyte janë paraqitur objektivat dhe prioritetet e komunës, plani afatmesëm, korniza e shpenzimeve buxhetore, plani i ndarjeve buxhetore sipas kategorive dhe viteve.
- pjesa e tretë ka të bëjë me deklaratën për misionin, vizionin dhe performancën sipas drejtorive, si dhe shtojca që ka të bëjë me buxhetimin e Përgjegjshëm gjinor.

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit (KABK 2022-2024), paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin 2022 dhe orientimet për vitet 2023-2024. Qëllimi kryesor i KAB-it është që të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën buxhetore sipas kategorive ekonomike për të përmbushur objektivat e përcaktuara me planet rregulluese dhe strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Në mbështetje të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri i Financave është i autorizuar dhe përgjegjës që të nxjerr Qarkoren e Parë Buxhetore 2022/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar buxhetor për çdo organizatë buxhetore. Me këtë qarkore buxhetore përcaktohen grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake për financimin e komunave për vitin 2022 dhe orientimet për vitet 2023-2024.

Granti i përgjithshëm

Granti i Përgjithshëm për komunat për vitin 2022 është në shumë prej 193,530,000 euro, ku nga kjo shumë është shpërndarë sipas formulës së grantit të përgjithshëm dhe sipas kriterëve dhe komunës së Hanit të Elezit i takon një shume prej 1,112,582 € për vitin 2022, ku ne krahasim me vitin 2021 kemi një rritje prej 56,625 €.

Granti specifik për Arsim parauniversitar

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI-t për vitin 2022.

Granti specifik për arsim para universitar për vitin 2022 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 201.5 milion euro, nga të cilat 195 milion euro grant bazë dhe 6.5 milion euro politika në vazhdimësi dhe politika të reja si në vijim;

Për komunën e Hanit të Elezit, bazuar në kriteret për formulën e arsimit, i takon një buxhet si grant baze në shume prej 86,420 €, si dhe politika të reja dhe në vazhdimësi në shume prej 74,538 €, ku hyjnë:

- -2 Asistent për fëmijet me nevojë të veçantë në shume prej 15,744 €,
- -mesimdhësit me gjendje të rëndë shëndetësore në shume prej 34,464 € dhe
- -shpenzimet për shujtën ditore për nxënësit 1-5 në shume prej 24,330 €.
- Totali i financimit të grantit të arsimit është në shume prej 939,957 €

Granti i shendetesise

Granti specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL.

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2022 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 62.6 milion euro. Komunës së Hanit të Elezit i takon një buxhet prej 325,871 € apo njëjtë sikur që është në këtë vit aktual.

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2022

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2022 bazuar në vlerësimet makro-fiskale, janë aprovuar në shumë prej 87.4 milion euro, këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Projeksioni i të hyrave vetanake për secilën komunë është bazuar në rekomandimet e komisionet e granteve, të përfshirë në raportin e “Vlerësimit të përshtatshmërisë së financimit të komunave”.

Në këtë projektion janë marr parasysh të hyrat e tatimit në pronat e paluajtshme sipas faturimit të tatimit në pronë (ngarkesat tatimore në pronë dhe në tokë) dhe mesatarja e tri viteve të fundit e të hyrave jo tatimore duke përjashtuar të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe gjobat në trafik, të hyra këto të cilat planifikohen nga niveli qendror. Për komunën e Hanit të Elezit planifikimi është paraparë të jetë në shumë prej 381,347 € për vitin 2022 apo një rritje prej 92,723 € apo 32%. Bazuar në qarkoren buxhetore 2022/01 Buxheti i Komunës së Hanit të Elezit për vitin fiskal 2022 parashikohet një buxhet në lartësi prej 2,759,758 € apo një rritje prej 239,592 € apo për 9.51 % më i madh në raport me vitin 2021, kurse për vitin 2023 kemi një parashikim të buxhetit në lartësi prej 2,903,855 € apo një rritje prej 144,097 € ose 5.22 % në raport me vitin 2022, si dhe për vitin 2024 vlerësohet një buxhet prej 3,039,398 € apo një rritje prej 135,543 € apo për 4.67 % më i madh në raport me vitin 2023.

Në vitin e parë buxhetor 2022 sipas këtyre parametrave, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve dhe atë si vijon:

- nga Grantet Qeveritare me pjesëmarrje prej 2,378,411 € apo 86.18 %
- nga të Hyrat Vetanake Komunale me pjesëmarrje prej 381,347 € apo 13.82 %
- totali (Grantet + THVK) me pjesëmarrje prej 2,759,758 € apo 100.00 %.

Struktura e shpenzimeve për vitet 2021-2024

Nr	Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	2021	2022	2023	2024
1	Paga dhe shtesa	1,602,781	1,756,083	1,639,313	1,647,511
2	Mallra dhe shërbime	335,258	385,975	377,576	384,912
3	Shpenzime komunale	67,000	67,700	68,150	68,150
4	Subvencione dhe transfere	75,000	80,000	81,500	83,500
5	Shpenzime kapitale	385,172	470,000	737,316	855,325
6	Rezerva	55,000	-	-	-
	Totali	2,520,166	2,759,758	2,903,855	3,039,398
	Struktura në (%)		9.51%	5.22%	4.67%

Objektivat e Komunës së Hanit të Elezit:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së Hanit të Elezit,
- Trajtimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore dhe legalizimit i tyre në tërë territorin e Hanit të Elezit,
- Hartimi i PZHK-së dhe Hartës zonale të komunës së Hanit të Elezit,
- Mbledhja e të arkëtueshmeve (borxhet nga të hyrat e tatimit në pronë, nga ushtrimi i veprimtarive biznesore dhe nga shfrytëzimi i pronës publike),
- Buxhetimi i obligimeve për projektet kapitale,
- Buxhetimi i obligimeve ndaj kontratës kolektive,
- Buxhetimi për shujtat ditore për nxënësit nga klasa 1-5,
- Përkrahja e bizneseve të reja dhe ekzistuese,
- Vazhdimi i rritjes së shërbimeve në QKMF dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për qytetarët,
- Trajtimi i barabartë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe skemës sociale,
- Ngritja e nivelit të cilësisë në arsim dhe edukim,
- Përkrahja e aktiviteteve të kulturës, rinisë dhe sportit,
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore,
- Zhvillimi i turizmit rural,
- Pyllëzimi i zonave të zhveshura,
- Zhvillimi dhe zgjerimi i aktiviteteve në sektorin e bujqësisë.

Kryesuesi thekson:- krahas propozimeve të qytetarëve të cilat i kemi dërguar me imell adresë i kemi edhe dy propozime që janë dhënë njëri ka të bëjë me rregullimin e kanalit për ujitje në vendin e quajtur LLOK , Rregullimi i një fushe për tenis në vendin e quajtur „Kodra”. Të planifikohen mjete buxhetore për ndarjen e bursave për studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Tetovës por ky propozim bien ndesh me rregulloren për ndarjen e bursave për studentët por mundet me u përfshi me një kategori tjetër buxhetore. Sa i përket propozimeve do të votohen në pako për me i votuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- në KPF u dakordua që me modifikuar planin zhvillimorë komunal për shkak se është në përfundim. Buxhetimi për shujtat ditorë për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë, nëse është marrë kopë pastë nga komuna e Prishtinës atje nuk ka funksionuar dhe është konsideruar si popullsitet nga të tjerët. Jemi në shkollë dhe nëse bëhet kjo përsëri nxënësit kanë me dalë me blerë pije energjike e nuk ka funksionuar dhe kërkoj që të hiqet. Mjetet e planifikuara kërkoj që të barten te propozimi që është dhënë nga z.Visar Hasallari për subvencionimin e studentëve të cilët studiojnë në Universitetin e Tetovës. z.Sabedin Hasallari ka kërkuar disa mbledhje më herët që të shikohen mundësitë buxhetore për i me i ndihmuar nxënësit e shkollës së mesme. Nga ajo që kam lexuar më shumë më janë dokur teori të thata se sa platformë politike lokale elektorale sikur se janë shujtat te arsimtarët për vitin 2017 që përcaktohen në bazë të kontratës

kolektive që është bërë bajgi zhurmë që me u miratuar në kuvend e që nuk ka pasur nevojë me u miratuar sepse ka qenë e përcaktuar me kontratë kolektive dhe ka qenë obligative me kryer dhe tash e keni kryer duke u marr me gjykatë dhe e keni sjellë punën në gjykatë me shkuar për me kryer një marrëveshje kolektive që është e përcaktuar në bazë të legjislacionit dhe përsëri e keni paraparë këtu por nuk e keni paraparë se si do ta mbulonit edhe vitet tjera për shkak se është një shumë jo aq e vogël. Jam për me i votuar propozimet e qytetarëve por nuk do ta ngris dorën për këtë kornizë sepse nuk e shohë që i plotëson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Në KPF e diskutuam çështjen e ujit dhe në kornizë buxhetore nuk është paraparë edhe pse u diskutua që do të bëhet përmes CDI-së por këto fjalë janë që dymbëdhjetë vite. Janë mundur me bërë diçka përmes puseve por nuk është bërë zgjidhje. Është mirë që si qeverisje së bashku me kryetarin e komunës me dal dhe me kërkuar falje drejt për drejt qytetarëve sepse ne kemi bërë përpjekje me bërë zgjidhje por nuk arritëm. Në komunë nuk ka transparencë sepse qytetari nuk është i njoftuar me zhvillimet të cilat bëhen në komunë.

Florim Shkreta thekson:- shuma e cila është planifikuar prej 23 000 € a është në rregull sepse po më doket që është pak.

Sead Vila thekson:- granti specifik për arsim faqe 12 në dy kolona është përsëritur asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta. Këta punëtorë që do të punësohen do të ishte mirë që t'i përfshijnë të gjithë nxënësit në shkollat e Komunës së Hanit të Elezit të gjithë fëmijët të cilët kanë nevojë. Është planifikuar buxheti për mësimdhënësit të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe propozoj që të gjinden mundësi dhe forma të tjera që jo i njëjti mësimdhënës me i mbajtur dy ndërrime apo me shkuar prej grupit në grup për shkak se nuk e ka efikasitetin e punës në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Çështja e shujtave ditore për fëmijët për mu është e mirëseardhur duke u bazuar në dy komponentat si siguria dhe barazia. Fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e pestë kur vjen koha e pushimit vrapojnë dhe nuk dinë se ka shkojnë dhe në prindërit nuk kemi kontakt të vazhdueshëm dhe mësimdhënësit ndoshta nuk mund të i kontrollojnë dhe për mu ky ushqim do të ishte i mirëseardhur që t'i servohet në klasë edhe për shkak çështjes së sigurisë por në të njëjtën kohë krijojnë një barazi se jo gjithë prindërit i kanë mundësitë e njëjta ekonomike. Duhet të planifikohet mirë që të jetë gjithë përfshirja dhe ushqimi të jetë cilësorë.

Sabedin Hasallari thekson:- të hyrat vetanake parashihen të rriten në vitin 2022 prej 32 % . Ku është bazuar kjo rritje e cila është paraparë dhe a ka kategori të tjera që planifikoni për me i tatimuar. Performanca e të hyrave a ndikon në ndarjen e grantit qeveritarë. Te projektet kapitale propozoj që rruga nga Lagja e Re deri te fshati Hasallar të asfaltohet.

Habib Thaçi thekson:- faqe 29 pika 15 që parashihet ndërtimi i trotuareve për këmbësorë në zonat urbane dhe rurale. Propozoj që në kuadër të këtij projekti të parashihet edhe rruga "Isen Suma" sepse paraqet një rrezik për fëmijët të cilët udhetojnë për në shkollë dhe të vendosen edhe pengesa në rrugë sepse po ka lëvizje të shpejtë të veturave. Në fshatin Krivenik kanalizimi ka problem dhe nëse ka mundësi buxhetore me u kryer më shpejtë . Kërkoj sqarim për buxhetimin gjinorë. Sa kanë qenë subvencionet për klubet sportive për vitin 2021 dhe sa parashihen për vitin 2022. Subvencionimet të cilat janë dhënë a kemi marr ndonjë raport nga këto klube.

Sabrije Krasniqi thekson:- është mirë që janë planifikuar shujta dhe po që se ekziston mundësia të planifikohet edhe për klasat e tjera . Te investimet kapitale që parashihet ndërtimi i banesave sociale më herët ka qenë 15000 € tash janë planifikuar 75 000 € dhe pasi është rrit shuma a keni gjet donatorë apo doni me bërë vetë. Propozoj që të bëhen kënde të lodrave në qytet dhe nëpër të gjitha fshatrat e Komunës së Hanit të Elezit.

Shabi Rexhallari thekson:- është vendim i Qeverisë që shujta me i dhënë nxënësve nga klasa e parë deri në klasën e pestë dhe nuk mundemi me hekë për shkak se Qeveria e ka paraparë. Deri në miratimin e buxhetit duhet të shikohen mundësitë se a mundemi me shtuar edhe për klasën e gjashtë deri në klasën e nëntë. Kjo është një shumë e vogël por në takimet që do të kemi me nivelin qendrorë do të paraqesim opinionet tona rreth kësaj çështje. Mjetet të cilat janë planifikuar për shujta janë paraparë nga mallrat dhe shërbimet dhe nuk mundemi me i dedikuar në kategorinë e subvencioneve për shkak se nuk lejohet me u bërë modifikimi. Shujtat për mësimdhënësit janë paraparë të pagat por kjo mbetet të shikohet në qarkoren e dytë që do të vijë nga Qeveria. Në qarkoren buxhetore janë paraparë dy asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta të cilët do të fillojnë nga muaji janar. Mësimdhënësit me gjendje të rëndë shëndetësore Ministria i ka planifikuar në bazë të kërkesës që e ka parashtruar drejtoria e arsimit. Ministria e ka paraparë këtë shumë për të hyrat vetanake duke e marrë për bazë edhe borxhet të cilat i kanë ndaj komunës për shkak të borxheve të tatimit në pronë, taksat për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve dhe taksat e qirasë që nuk i kanë paguar. Performanca e të hyrave nuk ndikon në grantin qeveritarë. Projektet e kubëzave të betonit janë planifikuar në mënyrë të përgjithshme dhe kjo do të varet sa do të kemi mjete buxhetore. Rregullimi i kanalizimeve është në mënyrë të përgjithshme por janë të cekura fshatrat. Te buxheti gjinorë është në fund të dokumentit që na kërkohet nga Ministria e Financave dhe në kuadër të pagave merret totali sa shpenzohet, merret komplet numri i të punësuarve dhe ndahet gjinia mashkull dhe femër, përcaktohet sa mjete shkojnë për femra dhe sa mjete shkojnë për meshkuj. E njëjta është edhe për subvencionet sa prej tyre shpenzohen për meshkuj dhe sa prej tyre shpenzohen për femra. Për vitin 2021 ende nuk është shpallur thirrja për subvencione në sport dhe janë të planifikuara 20 000 € që do të përfshihen edhe klubet e tjera. Për vitin 2020 ende nuk i kanë dërguar raportet klubet sportive por në momentin që bëhet shpallja i sjellin raportet se ku i kanë shpenzuar mjetet financiare. Ne e kemi planifikuar shumën 75 000 € por normal kërkohet donacion sepse nuk kemi mjete të mjaftueshme.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket shujtave unë nuk shohë që krijohet një barazi nëse u a dërgon ndonjë gotë qumësht dhe nuk janë paraparë kushtet elementare për me ja plotësuar kërkesën që ju e keni paraqitur sepse nuk është paraparë kuzhina dhe nuk mendoj që është ligjore që qeveria me të sugjeruar që me ju dhënë ushqim apo me i shpenzuar diku tjetër. Nëse ju mendoni që barazia e fëmijëve krijohet duke u dhënë nga një sandviç është gabim sepse barazia është duke krijuar një ambient të pastër, ujë të pijes, infrastrukturë, rekreacion, gjelbërim, shpresa për studime të barabarta, shpresa për punësim. Politikat që po i zhvillonin janë të gabueshme dhe populliste se nuk ka nevojë me lëmoshë me i mbajtur qytetarët sepse kuptohet që je tu e mbajtur për diçka tjetër. Për mua absolutisht nuk është e pranueshme kjo kornizë buxhetore me këto të cilat i keni paraqitur.

Sead Vila thekson:-sa i përket mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore, unë e shohë që ka pasur keq menaxhim për shkak se janë ndarë mjetet për me i zëvendësuar mësimdhënësit siç kanë funksionuar shumë komuna, ndërsa drejtoria e arsimit një gjë të tillë nuk e ka bërë. Është paraparë për vitin 2022 por unë i sugjeroj drejtorit të arsimit që në muajin shtatorë që do të fillon mësimi 2021-2022 me dalë në teren dhe me parë gjendjen për shkak se ka mësimdhënës të cilët vijnë me terapi shëndetësore.

Kryesuesi thekson:-sa i përket propozimeve keni mundësi me i propozuar kur të miratohet buxheti i komunës për vitin 2022.

Shabi Rexhallari thekson:- parashikimi i mjeteve për mësimdhënësit të cilët janë me gjendje të rëndë shëndetësore janë për vitin 2022, ndërsa vitin e kaluar që ka pasur mjete kanë qenë të dedikuara vetëm për kovid, ndërsa për këtë vit nuk ka paraparë Qeveria për me i ndihmuar komunitat për arsimtarët me gjendje të rëndë shëndetësore.

Hanumshahe Dibrani thekson:- çështjen e shujtave që në fillim e kam parashtruar si propozim por shpresoj të realizohet për shkak se dihet se çfarë ushqimi po konsumojnë fëmijët tanë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka propozimet e qytetarëve dhe propozimin e z. Sabedin Hasallari e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për , 4 abstenim (z Mehmet Ballazhi, z.Florim Shkreta, znj. Besarta Suma (nga grupi parlamentar i PDK-së) dhe z.Mefail Suma (nga grupi parlamentarë Nisma). Në tërësi e hedh në votim kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2022-2024 ; 11 për , 4 kundër (z Mehmet Ballazhi, z.Florim Shkreta, znj. Besarta Suma (nga grupi parlamentar i PDK-së)

U MIRATUA KORNIZA AFAT MESME BUXHETORE 2022-2024

4. Draft plani lokal i veprimit në mjedis 2021-2026.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhemdin Daci thekson:-materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- është për tu çuditur diçka në këtë plan nuk është hera e parë që marr pjesë si asamblistë por fjala e kryetarit të komunës gjatë veprimit që ju dërgohet asamblistëve është pak e tepërt , a është populliste , a është para fushatë apo është fushatë këtë nuk e di. Komisioni që është caktuar prej dikujt e ka luajtur rolin e gjyshit në thënie latin që thotë gjyshi tregon përralla pra komisioni ka treguar përralla dhe ne asamblistët nuk jemi fëmijë. Për këto punë që parashihen nuk kam parë asnjë plan të veprimit, a është përshkrim apo është marr kopë pastë prej dikujt dhe anëtarët e komisionit në krahasim me planin nuk përkojnë sepse nuk kanë njohuri për këtë plan. Anëtarët e komisionit nuk i dinë kufijtë e Hanit të Elezit që kufizohen me Maqedoninë sepse asnjë herë nuk kanë dalur dhe po më doket që është kthyer mbrapa 2021-2016 . Diku i keni përmendur Romakët dhe kush është para Romakëve nuk përmendet askush. Përmenden disa trashëgimi kulturore si Xhamiat, Shtëpitë, Mullijt athu a s'ka edhe tjetër send sepse në bazë të këtij plani del se ne jemi ardhacakë . Askush nuk ka dal prej komunës që me caktuar një komision apo me caktuar person adekuat që me parë natyrë se çka ka në Han të Elezit . Kodra përmbi fshatin Dimëc është plotë shpella dhe prej tyre ka shpella qe janë afër njëqind metra të thella , ka varreza të vjetra. Në plan nuk është paraparë ajo që i mungon komunës duke përfshirë turizmin, themelet e kishave që janë në Han të Elezit. Dy të tretat e këtij plani janë përshkrim i situatës që ka kaluar dhe e gjendjes së tanishme dhe për të ardhmen mbetet një e treta. Është një plan pa plan nuk kam parë diçka konkrete që flitet në atë plan por vetëm me bërë një përshkrim voluminozë dhe me u a dërguar personave për me i lexuar dhe po më doket që po e ndini vetën më të dishëm dhe po i nënçmoni këta që ishin përpara dhe kjo nuk është mirë.

Kryesuesi thekson:- nënçmim nuk ka se jeni duke luajtur rolin e këshilltarit dhe të drejtën e fjalës e keni dhe kompetencat të cilat i keni jeni duke i shfrytëzuar.

Besarta Suma thekson:- duke pasur parasysh që kompania "Sharrcem" është ndotësi më i madh në Han të Elezit , a jeni interesuar ndonjë herë se çfarë filtra përdorë dhe si e menaxhon ndotjen. A është i mjaftueshëm vetëm një stacion për monitorimin e ajrit dhe a duhet të ketë edhe stacione të tjera dy apo tri pajisje të vogla të cilat duhet të jenë të vendosura nëpër hapësirat e ndotura . A është vendosur si pikë referuese që me pasur park të qytetit apo kanë me vazhduar qytetarët që me ndjetë në ulëset para komunës. Kur do të furnizohen banorët e Hanit të Elezit me ujë të pijes.

Nexhemdin Daci thekson:- është dokument specifikë dhe duhet të jetë fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës sepse çështja e mjedisit është specifike dhe nuk mundet me rregulluar komuna nëse ne vetë nuk bëjmë përpjekje secili prej neve . Vërejtje të cilat i paraqite për Xhamiat dhe Kishat ke të drejtë por ky dokument është më i rëndësishëm për mjedisin dhe është mirë të epen propozime konkrete se si me përmirësuar mjedisin . Shumica që u përmendën nga parafolësit është mirë që me u përfshirë në Plan Zhvillimorë për shkak se është dokument bazik por këtu përqendrimi më i madh është te veprimet konkrete të cilat kanë të bëjnë me mjedis . Sa i përket kompanisë “Sharrcem” nuk kemi qasje për shkak se ata e kanë lejen e integruar mjedisore të cilat i kanë të përshkruara veprimet që duhet të i bëjnë sa i përket çështjeve mjedisore dhe janë në kontroll të drejtë për drejtë të Ministrisë . Komuna zakonisht jep vërejtje çdo herë kur ka ndotje dhe për te çështja e filterëve nuk kemi qasje dhe sipas informacioneve që kam janë të mirë, mirëpo çështja e mirëmbajtjes është problem tjetër. Stacioni i monitorimit të ajrit është në kuadër të Institutit Hidrometrologjik dhe ka mundësi me u vendosur edhe në disa pika por varet prej mundësive buxhetore . Parku i qytetit është paraparë te çerdhja dhe është dashur në këtë vit me u ndërtuar por për shkak situatës me kovid ka ngecur puna.

Mefail Suma thekson:- në trashëgimi kulturore që përmendet bëjnë pjesë edhe varrezat pavarësisht se cilës fe i takojnë. U përmendë që ky plan ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisi e sa i përket mjedisit a vetëm ajri mbrohet apo duhet të ketë edhe ujë sepse askund nuk është përmendur çështja e problemit të ujit që është. U përmend nga parafolësit se kur do të ketë ujë të pijes për shkak se shumë vite keni potencuar se bënë kompania “Bifurkacioni” dhe vazhdimisht me mashtrime.

Habib Thaçi thekson:- cilat janë kompetencat e komunës për menaxhimin e cilësisë së ajrit. Aparati për matjen e cilësisë së ajrit që është te shkolla mendoj që nuk është në vendin e duhur. Për deri sa nuk kemi qasje si qytetarë do të shihet mirë prej komunës me vendosur me vendosur aparate për matje të cilësisë së ajrit që në të njëjtën kohë me i parë statistikën dhe cilësitë e ajrit dhe nëse shihen që rezultatet ton që nuk përputhen me ato atëherë duhet të intervenojmë sepse me gjithë këtë ndotje të ajrit nuk besoj që rezultate janë shumë të mira . Cilat janë prioritet në sektorin e mjedisit . A është e informuar komuna që në vendin e quajtur Zheden janë hapur gropa të mëdha për kërkimin e mineraleve dhe paraqesin rrezik për qytetarët dhe për kafshët. Prerja e pyjeve është një dukuri që është duke vazhduar vit pas viti dhe më brengosë problemi për personat të cilët prej pyje për nevojat familjare, ndërsa në anën tjetër bashkëpunohet me persona të cilët bëjnë tregti me dru. Duhet të ju kushtohet vëmendje atyre të cilët bëjnë biznes dhe familjet të cilat i kanë për nevojat e tyre mos me ju shkaktuar probleme

Nexhemdin Daci thekson:- të gjitha veprime të cilat do të i ndërmerr komuna do ta kenë inpaktin e vetë natyrisht nëse veprohet. Nëse implementohet do të varet se si do të vepron kuvendi i komunës dhe varet se a do të ketë buxhet. Te çështja e Zhedenit që u përmend është një kompani e cila e ka pëlqimin për hulumtim por nuk kam informata se a i ka bërë ato gropa ajo kompani për shkak se a jo është e obliguar me i kthyer në gjendje të mëparshme por më shumë aludojnë se ka ari dhe për atë çështje është edhe Policia e Kosovës.

Mehmet Ballazhi thekson:- në këtë plan të veprimit do të ishte mirë që të te projektet të jenë më konkrete sepse po lidhet gjithçka me buxhetin, me zhvillimin ekonomik , me arsimimin , me kulturën , me trashëgiminë kulturore dhe gjithçka po lidhet me këtë . Duhet të jemi ma koncizë në hartimin e planeve në mënyrë që me ditur se çka po bëjmë sepse është një plan pesë vjeçar dhe nuk mundemi me ditur për kërkesat e reja të cilat dalin . Fokusi jonë duhet të jetë te zhvillimi në përgjithësi. Te plani i eficiencës së energjisë potencohet rritja e komoditetit të energjisë, zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë në objektet publik, mirëpo nëse keni vendosur drita gjithë kund atëherë si keni me i zvogëluar shpenzimet për shkak se t’i je te rritur me investim e pastaj me u munduar me i zvogëluar i bien sikur me bërë hajgare. Duhet të dihet se ku jemi tu investuar në ambient për shkak se gjithë po potencojmë që kompania “Sharrcem” është ndotësi por ndoshta mund të jetë ndotësi më i vogël . Është diskutuar shumë herë për problemet të cilat janë me komunikacion dhe dje apo pardje ka ndodhur ndeshja në komunikacion për rrugën të cilën e kërkonin te kufiri dhe kjo donë zgjidhje sepse parametrat janë të gatshëm , kushtet janë të gatshme por nuk ka pasur vullnet me u ndërtuar. Është dashur me i parapri investimet te çështja e lumit Lepencë pavarësisht a mundemi me bërë apo

jo por nuk janë paraparë. Çështja e ujit që po flitet nuk është planifikuar. Trashëgimia kulturore ndoshta doket qesharake po në përgjithësi trashëgimia kulturore është zero sepse Hani i Elezit nuk e ka një dhomë muze e mos të themi shtëpi muze. Para pesëdhjetë viteve ka qenë një gjallni më e madhe në Han të Elezit por ka vdekur kjo gjallni dhe ne a është dashur me shkuar në regres a në progres.

Teuta Shkreta thekson:- drejtorja e urbanizmit i dinë saktë se cila kompani i ka bërë shpimet dhe mund të i dërgon inspektorët . Të vendoset një tabelë për ndalimin e dhezjes së zjarreve te pishat.

Sead Vila thekson:- faqe 22 popullsia dhe vendbanimet në fshatin Neqafc po figuron që ka një familje që me katër anëtarë dhe me sa e di unë që nga pas lufta ai vendbanim nuk ka banorë rezidentë që jetojnë atje dymbëdhjetë muaj të vitit dhe mendoj që kjo shifër statistikore është gabim. Nëse flasim për ekonomi familjare që punohet në mënyrë sezonale mund të jenë ndoshta edhe dhjetë. Është e pa pranueshme që të futet një ekonomi familjare kur ne e dimë dhe jemi familjarë me shumicën nga ata aty. Edhe pse është fshati më i vjetër nuk ka banorë rezidentë që jetojnë aty të përhershëm në atë fshat. A jeni në dioni që në shkollën e mesme “Dardania” është punuar me një grup nxënësish përmes financimit që është bërë nga Aseti dhe organizata Flosk sepse është vendosur një stacion për matjen e temperaturës, lagështisë së ajrit , pm 2.5 dhe pm 10.

Nexhemdin Daci thekson:-sa i përket gropave nuk kemi kapacitet që me i takuar personat e ndryshëm që kërkojnë ari sepse është e njoftuar edhe policia. Sa i përket banorëve në fshatin Neqafc do ta shikojë dokumentin. Për te shkolla e mesme “Dardania” nuk jam në dioni

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA DRAFT PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2021-2026 QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

5. Informatë për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- përveç materialeve të cilat i kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Florim Shkreta thekson:- ujitja e pishave te kompleksi “Bllaca 99 “ mendoj që duhet të jetë te parku “Hasan Prishtina”. Është dashur të shënohen sa herë janë ujit pishat për shkak se shumica janë duke u tharë . Punimet të cilat janë duke u bërë në rrugën për në fshatin Gorancë a është ankuar dikush nga komuna për këtë rrezik për në të ardhmen. Në KKSB a keni kërkuar që të ndërmerren masa për rrugën ka Terminali Doganorë dhe a keni ardhur në përfundim me bërë sa do pak një zgjidhje sepse ka pasur raste që personat mes vete kanë pasur probleme për shkak se nuk ka pasur rend dhe nuk ka pasur as polici.

Refet Kalisi thekson:- pishat janë ujitur tri herë. Çështja e rrugës është shqetësim për ne dhe për qytetarët por kryetari i komunës për këtë çështje ka intervenuar edhe në Ministrinë përkatëse

Teuta Shkreta thekson:- për çështjen e rrugës te kufiri ka ankesa të shumta prej qytetarëve për shkak se çdo ditë hasin në problemet e njëjta.

Kryesuesi thekson:- policia janë duke u munduar me mbajtur rendin dhe prej Ministrisë është premtuar që në periudhë prej tre deri në gjashtë muaj do të zgjidhet problemi.

Habib Thaçi thekson:- sa i përket qendrës së zjarrfikësve sipas informatave që kam ka ditë dhe javë që nuk punohet dhe unë mendoj që kjo është emergjente për shkak se mund të ndodhë zjarri dhe nuk ka zjarrfikës . Për këtë çështje duhet të parashihet buxhet dhe të rritet numri i zjarrfikësve dhe duhet të funksionon njëzet e katër orë.

Refet Kalisi thekson:-staf nuk kemi të mjaftueshëm dhe nuk na lejohet me shtuar stafi. Në rastet e zjarreve zjarrfikësit dalin dhe intervenojnë

Mehmet Ballazhi thekson:- në KPF kemi kërkuar me bërë zgjidhje emergjente për te rruga te kufiri. Policia dalin me mbajtur rendin por ndeshja ka ndodhur. Kërkesë kam pasur edhe më herët për vendosjen e mbrojtëseve në rrugë ku ka rënë vetura dhe ka humbur jetën fëmija nga fshati Gorancë dhe asnjë herë nuk është ndërmarr ndonjë mas për vendosjen e mbrojtëseve.

Sead Vila thekson:- ne e dimë që ka mungesë të burimeve njerëzore dhe nuk lejohen për me u shtuar por do të ishte mirë që gjatë sezonës së verës me u kompensuar punëtorët të cilët i kryejnë punët jashtë orarit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhemdin Daci thekson:- materialin e kam përgatitur dhe është dërguar me kohë nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sead Vila thekson:- defekti është në nivel qendrorë me këtë Ligj sepse nuk është menduar gjendja ekonomike e qytetarëve për me vendosur një tarifë aq të lartë për legalizim për shkak se për një shtëpi me 400 m² kostoja e legalizimit kushton afër 1000 € .

Mehmet Ballazhi thekson:-nëse nuk ka të interesuar për me i legalizuar objektet, duhet të bëhet sensibilizimi i qytetarëve dhe me i diskutuar problemet me qytetarë për këtë çështje dhe pastaj me marr një vendim se çka mund të ju ofron komuna për me ju ndihmuar. Ne nuk mund të ndikojmë në nivel qendrorë për çështjen e ligjit por si vërejtje duhet ta përcjellim në Qeveri.

Nexhemdin Daci thekson:- çmimet nuk janë të shtrenjta sepse nëse sot aplikon për leje të ndërtimit më shumë ka taksa se sa për legalizim. Në të ardhmen kjo çështje ka me u kryer

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

3. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- a ka inspektor komuna që me i përcjell kompanitë sepse kompania Telkos i reklamoi pakot me i paguar mujore dhe unë nuk përfshihem në atë pako. Inspektori komunal a e dinë në atë ndërmarrje private a veprohet sipas rregulloreve të cilat i ka.

Florim Shkreta thekson:- si qytetarë jemi keq në këtë aspekt por kur janë ardhur kompani të ndryshme për me investuar disa persona të cilët mund ti quaj si banda i kanë larguar dhe tash qytetari pëson. Disa të rinjë kanë ndërmarr një iniciativë për një gjë më elementare që ishte një kërkesë ligjore dhe si qytetarë duhet ta duartrokasim atë iniciativë, mirëpo shqetësuese është kur i shohë disa komente në rrjetet sociale por kjo vërejtje është më shumë për kryesuesin e kuvendit që e përfaqëson popullin dhe i përçanë të rinjtë dhe ta quan dikend, qenë, zagar dhe aty ku hanë duhet me le që kjo për mu është e pa pranueshme dhe turpshme sepse ke rënë me një nivel shumë të ulët.

Kryesuesi thekson:- nuk është mirë me shpifur sepse përgjegjësi unë jap për shkrimin tim sepse mendimin tim mund ta shprehi ashtu siç e shprehin të tjerët.

Florim Shkreta thekson:- nuk jam tu shpifur dhe as për inati nuk jam tu diskutuar por ju e shihni se të rinjtë tanë janë bërë grupacione të ndryshme nëpër shkolla dhe ne si asamblistë që i përfaqësojmë qytetarët e komunës së Hanit të Elezit nuk është mirë me gju gurin dhe me fshehur dorën. Është kërkuar një gjë elementare dhe në vend që ju me duartrokitur këtë iniciativë ju mundoheni nëpër mesazhe private me i kërcënuar.

Kryesuesi thekson:- në këto çështje nuk dua të hyjë sepse me një kohë në pushtet ka qenë partia e jote dhe më kanë minuar dhe je munduar edhe këto gjëra me i diskutuar në kuvend por nuk të ka dëzuar.

Florim Shkreta thekson:- për këtë temë që e potencove unë isha në favorin tënd për me i diskutuar por nuk e di a e ke kuptuar.

Isni Bushi thekson:- rasti rinisë mu personalisht nuk më ka pëlqyer për shkak se deri tash ishim kundër asaj se çka kanë barë edhe në pushtetin qendrorë kur është gjuajtur kuvendi sepse e kanë dëmtuar pronën publike. Problemi i ujit nuk është sot por është me vite dhe si rini a e kanë ofruar ndonjë takim me përfaqësuesit e komunës por direkt dëmtohet prona publike për shkak se ka metoda se si protestohet.

Mehmet Ballazhi thekson:- gjuha e urrejtjes të zyrtarë duke përfshirë edhe ty si kryesues që potencoj z. Florim Shkreta, duhet me pasur kujdes sepse edhe unë duhet me u turpëruar si anëtarë i kuvendit për shkak se kryesuesi i kuvendit me potencuar ashtu nuk është e pëlqyeshme, pavarësisht që ke drejtë me potencuar por e lejueshme në ligj moral nuk hynë kjo. Ju e dini mirë kur Ardian Kastrati e ka parafrazuar Faik Konicën dhe është përjashtuar prej këshillit të etikës dhe isha pro për me përjashtuar sepse nuk ka nevojë bulizëm me pasur. Nuk ka nevojë që me u marr me këtë gjuhë të urrejtjes sepse nxisim urrejtje sidomos kryesues ty dhe zyrtarët e tjerë. Komentet i pashë dhe nuk jam ithtarë i komenteve por më pëlqej që kishin shkruar me emër dhe mbiemër dhe si kryesues është mirë me potencuar që kërkoj falje nëse dikush më ka keqkuptuar e jo me u shprehur në atë mënyrë. Deri këtu ka ardhur duke ndrydhur mendimin e lirë të qytetarëve dhe janë pasojat e qeverisjes dymbëdhjetë vjeçare sepse është burgosur fjala e lirë. Sa e çuditshme ju vjen atë që e kanë shënuar por mu më pëlqej, mirëpo po më vjen turp se jam në moshë 54 vjeçare se për çdo ditë kisha kërkuar ujë dhe në shpinë ua kisha shënuar për shkak se është shprehje demokratike dhe mendim i qytetarëve.

Kryesuesi thekson:- në komunë hapësirë ju kam dhënë por edhe këto mënyra nuk më pëlqejnë sepse në pushtetin e kaluar në Prishtinë gjatë protestave në momentin që u hedhshin gurët unë jam larguar nga protesta për shkak se nuk e gjuaj institucionin tim dhe policinë time. Nga të rinjtë kërkoj që të vijnë në debat dhe debatojmë për çështje, ndërsa me bërë veprime në dëm të komunës nuk është mirë për shkak se si Han i Elezit merr një pamje të keqe.

Sabedin Hasallari thekson:- komentet nuk i kam lexuar por nëse ke potencuar ashtu siç theksuan parafolësit është mirë me kërkuar falje. Çështja e protestimit është e drejt e tyre dhe nuk ka të bëjë këtu me ndonjë parti politike, mirëpo nëse mendohet se është dëmtuar prona publike unë e paguaj sepse është djali im. Nuk duhet të merret tragjike se nuk është bërë asgjë, nuk ka humbur asnjë jetë njeriu.

Mefail Suma thekson:- fillimisht komuna duhet ti shikon se mos ka gabime të veta dhe unë po jap mendimin tim se boll është bërë më me mashtrime sepse çështja e ujit është bërë e tepërt. Nëse nënkuptohet që e ke thumbuar dikendë me atë që ke shkruar nuk është mirë. Duhet të punohet e jo vetëm me marr pushtetin e me fjet dhe më erdh keq që me flak jeni mundur me i shlyer shkrimet që janë shënuar.

Mehmet Ballazhi thekson:-nëse ka shkelje ligjore është mirë gjykata me vlerësuar e jo ty si kryesues apo zyrtarët e tjerë dhe si kryesues është mirë me shikuar mbarëvajtjen e kuvendit e jo me u kapur me ekzekutivin.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:38.

Procesmbajtësi

Avni Bushi

Kryesuesi i Kuvendit

MSc. Qamush Brava

